



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 05.02.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbylllet rasti APK-DPKI-06-1134/24, lidhur me pretendimet e ngritura nga një raportues i jashtëm për konflikt të mundshëm të interesit për z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë dhe z. Lorik Maxhuni, Drejtori i QKMF “Dr. Safet Idrizi” në Vushtrri, përkizati me konkursin publik Nr. 244/24, të datës 14.13.2024, të shpallur nga Komuna e Vushtrrisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një denoncimi nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (*citojmë*):

“[...]. B. M. është e punësuar në Konkursin e QKMF Vushtrri e punësuara si punonjëse e gardërobës në QKMF Vushtrri, Konkursi me nr. protokolli 244/24, dt. 16.04.2024. Kjo e punësuar është bashkëshortja e djalit të vllaut të Kryetarit të Komunës Ferit Idrizi, kurse drejtori i shëndetësisë Lorik Maxhuni, e ka vajzë e axhës së ti?!! Cili ishte më ndikues në këtë çështje: kryetari apo drejtori apo të dy bashkë, janë veprime që duhet bëhen transparente. Po ashtu duhet bëhen transparente sa konkurse të brendshme në QKMF u kurdisen vetëm e vetëm që të lirohej kjo pozitë?! Se a pati konflikt interesit në këtë rast ku kryetari punëson bashkëshorten e djalit të vllaut, kurse drejtori i shëndetësisë vajzën e axhës së vet në dikasterin që drejton personalisht dhe nënshkruan kontratat, i mbetët organeve përgjegjëse ta vendosin si çështje. [...]”

Pas pranimit të informatës si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, fillimisht me shkresën zyrtare DPKI-06-1214/24, ka kërkuar nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë informata, sqarime dhe dokumentacionin lidhur me konkursin publik Nr. 224/24, të datës 14.03.2024, të shpallur nga Komuna e Vushtrrisë. Duke vepruar sipas kërkesës në fjalë, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë z. Ferit Idrizi, ka dërguar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dokumentacionin përkatës lidhur me konkursin në fjalë (shkresa zyrtare: DPKI-06-1214-1/24).

Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacioni në dispozicion, komunikimit me Kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, rezulton se as Kryetari i Komunës, e as Drejtori i QKMF-së, nuk kanë pasur vendimmarrje, çaste paraprake apo çfarëdo ndikimi në këtë proces të rekrutimit.

Gjithashtu, për të vërtetuar afërsinë eventuale familjarc sikurse është pretenduar nga raportuesi i rastit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka dërguar kërkesë më shkrim (APK-DPKI-79/25) në Agjencinë për Regjistrimin Civil (ARC), dhe nga përgjigja e këtij institucioni (*shkresa zyrtare nr.: 02/982*) rezulton se (*citojmë nga shkresa e tyre*): “[...]. *Qytetarja B.M., me numrin personal [...] ka statusin martesor Beqare si rrjedhojë nuk mund të konfirmojmë pretendimet se është bashkëshortja e djalit të vëllait të Ferit Idrizi. Po ashtu është verifikuar lidhja e afërsisë familjare në mes të B. dhe Lorik Maxhuni me numër personal [...], sipas pretendimeve që të dytë kanë lidhjen familjare djalë dhe vajzë axhë, pas verifikimit në sistemin e Gjendjes Civile rezulton se nuk është lidhje e afërsisë siç është pretenduar, Lorik Maxhuni ka vetëm një axhë, tek të dhënët përfëmijët e axhës së Lorik Maxhuni nuk ekziston emri i B.M.*

Pra, ARC si institucion kompetent i gjendjes civile, përkatësisht i verifikimit dhe vërtetimit të afërsisë familjare mes shtetasve të Republikës së Kosovës, në pretendimin e parë nuk ka mundur të verifikoj afërsinë familjare në mes Ferit Idrizi dhe B.M., ndërsa në pretendimin e dytë, pas verifikimit nga sistemi i Gjendjes Civile ka rezultuar se Lorik Maxhuni dhe B.M. nuk kanë afërsi familjare sipas pretendimit të raportuesit të rastit.

Duhet theksuar se afërsia familjare në mes Ferit Idrizi dhe B.M., sipas pretendimit të raportuesit të rastit, nuk konsiderohet ‘*person të afërt*’ në kuptim të dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Kësisoj, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është përkufizuar nociioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund te ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [*Deklarimi rast përrast i interesave private të zyrtarit*], paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

“Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast përrast të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak përlindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiq nga kjo vendimmarrje.”

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

“Interesi privat i personit zyrtar - nënkuption çfarëdo përparësie përrast personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënies afariste”,

si dhe me nënparagrin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

“person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërm i një gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesit privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. [...].”

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definon nacionin vendimmarrje si:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilët vendoset përbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Pra, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së *interesit privat* të zyrtarit apo të personave të afërm me të në një çështje të caktuar. Për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe *interesi privat* i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin.

Sikurse u konstatua mësipër, përvç se nuk është vërtetuar afërsia familjare në kuptim të dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (*neni 6, lidhur me nenin 3, paragrafi 1.6*), në rastin konkret nuk është konstatuar të ketë pasur vendimmarrje apo çaste paraprake të vendimmarrjes në këtë proces të rekrutimit, prandaj në rastet kur nuk plotësohen (përbushen) kushtet e domosdoshme kumulative të konfliktit të interesit, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe *interesi privat* i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin, përjashtohet konflikti i interesit.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [*Procedura administrative e Agjencisë përrastet e konfliktit të interesit*], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: "Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimit tarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.", si dhe paragrafin 15 të këtij nenit, me të cilin është përcaktuar se: "Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës)

Ylli BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit